

POLITIKA E PRIVATËSISË

Agro Social Fund SHA (ASF) SHA është e përkushtuar të sigurojë një trajtim të drejtë, transparent dhe të mbrojtur të të dhënave tuaja personale, në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Kjo politikë paraqet mënyrën se si ASF administron të dhënat personale të individëve me të cilët ndërvepron, me ju.

Kjo politikë shpjegon proceset që përfshihen në përpunimin e të dhënave, si: mbledhja, seleksionimi, ruajtja, përdorimi, transmetimi, kufizimi, fshirja dhe shkatërrimi, si dhe masat që ndërmerren për garantimin e sigurisë së informacionit.

1. Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave personale

ASF përpunon të dhënat personale për qëllime të ofrimit të produkteve dhe shërbimeve financiare, administrimit të marrëdhënieve kontraktuale, përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe garantimit të integritetit të sistemit financiar.

Përpunimi përfshin: mbledhjen, regjistrimin, organizimin, ruajtjen, ndryshimin, rikthimin, përdorimin, konsultimin, kombinimin, bllokimin, fshirjen dhe shkatërrimin e të dhënave.

2. Kategoritë e të dhënave të mbledhura

ASF mund të përpunojë të dhëna si:

- Emri, mbiemri;
- Data/vendi i lindjes, kombësia;
- Adresa, numri i telefonit, e-maili;
- Të dhënat e dokumentit të identifikimit (ID/Passport);
- Të dhëna financiare për qëllime të shërbimeve të kreditimit;
- Të dhëna të nevojshme për verifikimin e identitetit (AML).

3. Si mblidhen të dhënat

- Përmes formularëve fizikë ose elektronikë;
- Në degët e ASF;
- Nëpërmjet platformave digjitale dhe aplikacioneve;
- Nga palë të treta të autorizuara nga ligji (autoritetet publike, institucione financiare etj.).

4. Qëllimet e përpunimit

Të dhënat personale përpunohen për:

- Administrimin e marrëdhënies financiare me klientin;
- Dhënien e shërbimeve të kreditimit;

- Verifikimin e identitetit dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore;
- Përmbushjen e kërkesave rregullatore nga Banka e Shqipërisë dhe autoritete të tjera kompetente;
- Mbrojtjen e interesave ligjore të ASF dhe klientëve;

5. Parimet e përpunimit

ASF përpunon të dhënat personale duke respektuar parimet ligjore:

- Ligjshmëria, drejtësia dhe transparencia;
- Qëllim i përcaktuar dhe i ligjshëm;
- Minimizimi i të dhënave;
- Saktësia dhe përditësimi;
- Ruajtje e kufizuar në kohë;
- Integriteti dhe konfidencialiteti;
- Përgjegjshmëria e kontrolluesit.

6. Aksesimi dhe ndarja e të dhënave

ASF mund të ndajë të dhënat personale vetëm në raste të domosdoshme, të ligjshme dhe me masa të adekuata sigurie me:

- Autoritetet shtetërore dhe rregullatore (Banka e Shqipërisë, DPT, Prokuroria, Policia etj.);
- Agjenci të informacionit kreditor;
- Partnerë të përpunimit (IT, auditim, pagesa, konsultim);
- Subjekte të treta vetëm me bazë ligjore ose pëlqim.

ASF nuk përdor dhe nuk transferon të dhënat personale për qëllime tregtare pa pëlqimin e individit.

Në rast se ASF duhet t'ua transmetojë të dhënat e mbledhura palëve të treta (partnerë të saj në biznes), si: të dhëna identifikuese dhe të dhëna mbi detyrimin kreditor në ASF, institucioni siguron subjektet e të dhënave se këto të dhëna përdoren vetëm për qëllimin e realizimit të shërbimit, për qëllimin për të cilin përdoruesi ka deklaruar vullnetarisht të dhënat e tij personale. Në këto raste ASF siguron përdoruesit se kontratat e lidhura me të tretët për këtë qëllim përmbajnë klauzola kontraktuale të qarta në të cilat parashikohen kushtet e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit.

7. Të dhëna nga palë të treta

ASF mbledh të dhëna të palëve të treta vetëm kur kjo kërkohet nga një marrëdhënie kontraktore dhe vetëm në masën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së saj financiare, për relizimin e aktiviteteve dhe për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Një përpunim i tillë mbulon të dhënat personale të palëve të treta, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- të dhëna identifikuese (si p.sh: emër, mbiemër)

- të dhënat/aktivitetet e biznesit (si p.sh: shërbimet e ofruara);
- detajet financiare (si p.sh: informacioni i llogarisë bankare);
- informacion fotografik-video (si p.sh: imazhe CCTV);
- të tjera, në varësi të plotësimit të këtij qëllimi.

8. Transferimet ndërkombëtare

Në rast transferimi të të dhënave jashtë Republikës së Shqipërisë kryhet vetëm:

- Me pëlqim të subjektit të të dhënave;
- Kur vendi pritës garanton nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje;
- Në përputhje të plotë me nenet 39-42 të ligjit nr. 124/2024;
- Në bazë të marrëveshjeve të miratuara kontraktuale sipas GDPR;

9. Ruajtja e të dhënave

ASF i ruan të dhënat personale për periudhën minimale të nevojshme për përmbushjen e qëllimeve përkatëse ose për atë kohë sa kërkohet nga legjislacioni shqiptar, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Ligji nr.7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
- Ligji nr.7961, datë 12.7.1995,, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë",i ndryshuar;
- Ligji nr. 25/2018 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 "Per Arkivat", I ndryshuar;
- Ligji nr. 9917/2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", të ndryshuar;
- Rregullore 1/2013 "Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka".

10. Masat për sigurinë e të dhënave

ASF ka ndërmarrë masat e nevojshme dhe të përshtshme për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me Ligjin Nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe standardin ISO 27001:2022. Masat e ndërmarrja janë:

- baza dokumentare/procedurat e ngritur ne funksion të mbrojtjes së të dhënave;
- masa teknike dhe organizative për mbrojtje të të dhënave:
 - kontroll i aksesit;
 - sisteme enkriptimi dhe firewall-i;
 - monitorim i vazhdueshëm i sistemeve;
 - procedura për menaxhimin e incidenteve të sigurisë.
- trajnim periodik i stafit për mbrojtjen e të dhënave.

Kët masa shërbejnë për të garantuar mbrojtjen e të dhënave nga humbja, shkatërrimi, ndryshimi, zbulimi apo aksesimi i paautorizuar, si edhe për t'i parandaluar të gjitha format e tjera të përpunimit të paligjshëm.

11. Të drejtat e subjektit të të dhënave

Subjekti i të dhënave ka të drejtë e mëposhtme:

- E drejta për t'u informuar
- E drejta e aksesit
- E drejta për korrigjim
- E drejta për fshirje/për tu harruar
- E drejta për kufizimin e përpunimit
- E drejta për transportueshmërinë e të dhënave
- E drejta për kundërshtim
- E drejta për vendimarrje të automatizuar
- Të paraqesë ankesë pranë Komisionerit: www.idp.al.

Kërkesat e individëve trajtohen nga ASF brenda afateve ligjore.

Gjithashtu, subjekti i të dhënave duhet të informojë ASF për çdo ndryshim në të dhënat personale që mund të ndikojë në ofrimin e shërbimeve. Çdo ndryshim kryhet në degët e ASF-së.

Për ushtrimin e të drejtave tuaja, mund të kontaktoni në:

Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave (DPO) në ASF

E-mail: gsheshi@asfund.org / gsheshi@asf.al

Agro Social Fund SHA (ASF)

Adresa e selisë qendrore:

Rr. "Rr. Nikolla Lena" Hyrja 1, Ap. 25, Tiranë

Tel: +355 46 31 57 43

E-mail: info@asf.al